



Qeveria e Kosovës
Vlada Kosova - Government of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Zyra për Qeverisje të Mirë / Kancelarija za Dobro Upravljanje / Office on Good Governance

STRATEGJIA QEVERITARE PËR BASHKËPUNIM ME SHOQËRINË CIVILE 2019–2023

Prishtinë 2019



6	Lista e shkurtesave
7	Përmbledhje ekzekutive
8	Hyrje
9	Gjendja e shoqërisë civile dhe nevojat e saj
10	Metodologjia
11	Historiku i Problemit
13	Objektivat Strategjike
13	<i><u>Objektivi strategjik 1.</u> Rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në politikë-bërje</i>
14	<i><u>Objektivi strategjik 2.</u> Përmirësimi i kornizës institucionale dhe ligjore për financim në zhvillimin e qëndrueshëm të programeve dhe projekteve të OShC-ve me interes publik</i>
15	<i><u>Objektivi strategjik 3.</u> Zhvillimi i praktikave dhe procedurave për kontraktimin e OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve publike</i>
15	<i><u>Objektivi strategjik 4.</u> Rritja e vullnetarizmit në programet me interes publik</i>
16	Monitorimi dhe Vlerësimi i Zbatimit të Strategjisë
18	Funksionalizimi i procesit të monitorimit dhe vlerësimit
20	Ndikimet Financiare në Implementimin e Strategjisë
22	Shtojca 1 Plani i Veprimit
46	Shtojca 2 Lista e Anëtarëve të Ekipit të Punës (EP)
47	Shtojca 3 Organizimi Institucional
48	Shtojca 4 Përcaktimi i Treguesve Matës
49	Shtojca 5 Termat kryesore

LISTA E SHKURTESAVE

ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZQM-ZKM	Zyra për Qeverisje të Mirë - Zyra e Kryeministrit
OSHC	Organizatat e shoqërisë civile
DOJQ	Departamenti për OJQ-të
KE	Komisioni Evropian
BE	Bashkimi Evropian
KCSF	Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
IKS	Iniciativa Kosovare për Stabilitet
M&V	Monitorimi dhe vlerësimi
MAPL	Ministria e Administrimit të pushtetit lokal
MKRS	Ministria e kulturës, rinisë dhe sportit
MIE	Ministria e integritit evropian
MPMS	Ministria e punës dhe mirëqenies sociale
MF	Ministria e Financave
MAP	Ministria e Administratës Publike
OJQ	Organizata joqeveritare
OPP	Organizatë me status për përfitim publik
ASHB	Analiza e shkakut bazë
AT	Asistenca teknike
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
GP	Grupi punues
EP	Ekipi i punës

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Krijimi i një kornize përkrahëse ligjore, institucionale dhe financiare për bashkëpunim në mes të qeverisë dhe shoqërisë civile është një ndër treguesit thelbësor të pjekurisë së demokracive moderne. Shoqëria civile e fuqizuar dhe aktive mund të kontribuojë në formësimin e një legjislacioni më të mirë, ofrimin e shërbimeve më të mira publike, sigurimin e monitorimit më efikas të zbatimit të reformave kyçe të politikave dhe përmirësimin e vullnetarizmit qytetar. Roli i shoqërisë civile në procesin e integritimit evropian në parim është përfshirë në një sërë dokumentesh zyrtare të BE-së dhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ku partneriteti në mes të qeverisë dhe shoqërisë civile është kthyer në prioritet të saj.

Strategjia e parë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile (2013-2017) është miratuar në korrik të vitit 2013 si shenjë e rëndësishme e njohjes së rolit të shoqërisë civile nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës në politikë-bërje dhe në qeverisje të mirë. Kjo Strategji u dizajnuar për të ndihmuar në përmirësimin e bashkëpunimit të qeverisë me shoqërinë civile në kontekstin e katër objektivave strategjike:

- Sigurimi i pjesëmarrjes të shoqërisë civile në hartimin e politikave dhe legjislacionit,
- Krijimi i një sistemi për kontraktimin e OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve,
- Vendosja e sistemit financiar dhe paracaktimi i kriterëve për mbështetjen e shoqërisë civile me fonde publike, si dhe
- Promovimi i një qasjeje të integruar për zhvillimin e vullnetarizmit në vend.

Vlerësimi i zbatimit të Strategjisë së parë për periudhën 2013-2017 është udhëhequr nga Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit (ZQM/ZKM) me mbështetjen e projektit për asistencë teknike të BE-së “Mbështetje për zbatimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqëri civile 2013-2017”, i cili ka konfirmuar arritjen e një përparimi domethënës në fushën e konsultimeve publike në procesin e politikë-bërjes, në financimin publik të programeve dhe projekteve të OSHC-ve, ndërsa më pak përparim është shënuar në fushat e zhvillimit të vullnetarizmit dhe në përmirësimin e standardeve në ofrimin e shërbimeve publike nga OSHC-të. Ky vlerësim po ashtu ka theksuar rëndësinë e objektivave strategjike dhe ka adresuar edhe sfidat dhe mësimet e nxjerra nga ky proces. Në këtë vlerësim është përfshirë edhe nevoja për fuqizimin e mëtejshëm të burimeve njerëzore dhe financiare për Zyrën për Qeverisje të Mirë/ Zyrën e Kryeministrit dhe pjesëmarrje të shtuar e cilësore të Institucioneve përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve përkatëse.

Me miratimin e Strategjisë së re Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile 2019-2023, Qeveria e Republikës së Kosovës tregon përkushtimin e saj për të investuar burime plotësuese financiare dhe njerëzore me qëllim të krijimit të mekanizmave funksional për një bashkëpunim të strukturuar në mes të qeverisë dhe organizatave të shoqërisë civile. Kjo do të ndihmojë në formësimin dhe zbatimin e politikave publike si dhe krijimin e një mjedisi më të favorshëm për zhvillimin e shoqërisë civile. Për të arritur këtë synim janë vendosur katër objektiva strategjike për periudhën e zbatimit 2019-2023:

1. Rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në politikë-bërje,
2. Rritja e llogaridhënies dhe transparencës në financimin publik për OSHC-të,
3. Zhvillimi i praktikave dhe procedurave për kontraktimin e OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve publike dhe
4. Rritja dhe promovimi i vullnetarizmit në programet me interes publik.

Krahas fondeve nga buxheti i shtetit, zbatimi i këtyre objektivave strategjike do të përkrahet edhe nga asistencë teknike e BE-së si dhe priten fonde shtesë nga donatorë në fushën e zhvillimit të shoqërisë civile, si dhe nga OSHC-të të cilat e kanë për mision zhvillimin e shoqërisë civile ose fushat specifike të trajtuara nga objektivat strategjike përkatëse. Metodologjia e përgjithshme për monitorimin dhe raportimin mbi zbatimin e kësaj Strategjie është përshtatur duke e vënë theksin në përkufizimin e treguesve për secilin prej objektivave strategjike si dhe përcaktimin e arritjeve të qarta për secilin vit të caktuar sipas Planit të Veprimit.

Hyrje

Kjo Strategji i përkufizon objektivat strategjike dhe politikat që Qeveria e Republikës së Kosovës synon t'i arrijë në njëperiudhë afatmesme për përmirësimin e mjedisit përkrahës në zhvillimin e shoqërisë civile si dhe krijimin e parakushteve për një bashkëpunim më efektiv me OSHC-të për reformat kryesore në vend. Një shoqëri civile aktive dhe e fuqizuar konsiderohet si një përbërës thelbësor i demokracive moderne pluraliste. Prandaj, zhvillimi i bashkëpunimit në mes të qeverisë dhe shoqërisë civile në formësimin dhe zbatimin e politikave publike është thelbësore në zhvillimin gjithëpërfshirës të qeverisjes së orientuar drejt qytetarit dhe respektimit të diversitetit në të gjitha aspektet e shoqërisë. Strategjia e BE-së për *“Një perspektivë zgjerimi e besueshme për një angazhim të shtuar të BE-së me Ballkanin Perëndimor”* e muajit shkurt 2018¹ thekson se një mjedis përkrahës ligjor, institucional dhe financiar për shoqërinë civile është thelbësor dhe se qeveritë duhet të sigurojnë pjesëmarrje aktive të OSHC-ve në proceset e reformave dhe politikë-bërjes përmes vendosjes së një dialogu gjithëpërfshirës dhe të strukturuar. Udhëzimet për mbështetjen e BE-së për shoqërinë civile në vendet e zgjerimit 2014-2020² të miratuara nga Drejtoria e përgjithshme për Zgjerim e BE-së, theksojnë rëndësinë e vendosjes së objektivave të qarta, rezultateve dhe treguesve për monitorimin e përparimit të qeverive në këtë fushë. Këto elemente janë bërë një pjesë e rëndësishme për kriteret politike dhe pasqyrohen rregullisht në raportet vjetore për progresin e Kosovës në procesin e integritimit në BE duke ju referuar preambulës së MSA-se, pika 4, zhvillimi i shoqërisë civile dhe demokratizimi përfshihen si elementet e para mbi të cilat palët (përfshirë Republikën e Kosovës) angazhohen për të kontribuar në stabilizimin politik, ekonomik dhe institucional të Kosovës dhe rajonit.

Gjithashtu, vlen të theksohet edhe Strategjia për Rregullim me të Mire 2.0, procesi i Reformës së Administratës Publike, si dhe Përkrahje Direkte Buxhetore e BE-se për Reformën e Administratës Publike, procese të cilat janë të ndërlidhura drejtpërdrejte me këtë Strategji.

Për t'iu përgjigjur nevojës në rritje për një qasje më strategjike dhe për një plan të qartë drejt arritjes së bashkëpunimit domethënës me shoqërinë civile, në korrik të vitit 2013, Qeveria e Republikës së Kosovës kishte miratuar strategjinë e parë qeveritare dhe planin e veprimit për bashkëpunimin me shoqërinë civile 2013-2017. Me qëllim që të sigurohej monitorimi efektiv i zbatimit të asaj Strategjie, qeveria kishte themeluar Këshillin për zbatimin e strategjisë për bashkëpunim Qeveri-Shoqëri civile, i cili bashkë-kryesohej nga përfaqësues të qeverisë dhe shoqërisë civile me mbështetje profesionale dhe administrative nga Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit. Duke filluar nga marsi i vitit 2016, zbatimi i Strategjisë është mbështet nga Projekti i Asistencës Teknike të BE-së, “Mbështetje për zbatimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqëri civile 2013-2017”.

Gjatë vitit të fundit të zbatimit të Strategjisë, më 12 korrik 2017, Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit miratoi vendimin për krijimin e Ekipit të Punës për hartimin e Strategjisë së re qeveritare dhe Planin e Veprimit për bashkëpunimin me shoqërinë civile 2019-2023. Në ekip janë përfshirë përfaqësues të institucioneve përkatëse të qeverisë dhe OSHC-ve, ndërkohë grupi është zgjeruar edhe me përfaqësues tjerë të shoqërisë civile, nëpërmjet thirrjes dhe procesit të hapur të përzgjedhjes. Me qëllim të sigurimit të një baze të qëndrueshme analitike për zhvillimin e Strategjisë së re dhe Planit të Veprimit, është bërë vlerësimi i zbatimit të Strategjisë 2013-2017. Ky vlerësim ka analizuar shkaqet kryesore të problemeve në kuadër të secilit objektivi strategjik si dhe është përpiluar një listë e rekomandimeve që janë marrë parasysh gjatë hartimit të Strategjisë së re qeveritare dhe Planit të Veprimit.

¹ Komunikata e Komisionit Evropian “Një perspektivë zgjerimi e besueshme për një angazhim të shtuar të BE-së me Ballkanin Perëndimor”, COM (2018) 65 final, 6 shkurt 2018.

² Komisioni Evropian, “DP për Zgjerim: Udhëzime për mbështetjen e BE-së për shoqërinë civile në vendet candidate për zgjerim 2014-2020,” Nëntor 2013, fq. 4.

Objektivat e Strategjisë 2019-2023 janë vendosur në bazë të konsultimeve me shoqërinë civile duke i marrë parasysh rezultatet e vlerësimit për strategjinë e mëparshme si dhe prioritetet e vendosura në dokumentet përkatëse të Bashkimit Evropian. Në këtë mënyrë është siguruar përmbushja dhe vazhdimësia e objektivave dhe masave të planifikuara në dokumentet e tjera strategjike përkatëse të qeverisë, gjegjësisht në Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021, Strategjinë Kombëtare për zhvillimore 2016-2021, Strategjinë për Rregullim më të Mirë 2017-2021, Strategjinë për Përmirësimin e Planifikimit dhe Bashkërendimit të Politikave në Kosovë 2017-2021.

Gjendja e shoqërisë civile dhe nevojat e saj

Hapi i parë në zhvillimin e një kornize për bashkëpunim me shoqërinë civile në Kosovë ka qene nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë dhe platformës Civikos në vitin 2007. Në korrik të vitit 2013, Qeveria ka miratuar Strategjinë e saj të parë për bashkëpunim me shoqërinë civile për periudhën 2013-2017.

OShC-të në Republikën e Kosovës veprojnë dhe funksionojnë si fondacione ose shoqata në bazë të Ligjit për Lirinë e Asocimit të OJQ-ve (Ligji Nr. 04 / L-057) 2011³

Përfshirja e publikut dhe shoqërisë civile në procesin e politikë-bërjes dhe vendim-marrjes është vendosur përmes Rregullores për Standardet Minimale për Konsultimin Publik (Nr. 05/2016), e cila ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2017. Rregullorja e obligon Qeverinë të fillojë procesin e konsultimit publik në faza të hershme të hartimit të ligjeve ose politikave dhe përcakton standardet minimale të procesit të konsultimit duke përfshirë afatet, metodat, monitorimin, raportimin, etj. Zbatimi i standardeve të vendosura është mundësuar nëpërmjet Platformës Online për konsultimet me publikun⁴, e cila menaxhohet nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit. Institucionet qeveritare obligohen të publikojnë të gjitha dokumentet që janë subjekt i konsultimeve publike, ndërsa publiku mund të kontribuojë drejtpërdrejt në dokumentet e publikuara. Platforma online është metoda kryesore e konsultimit për dokumentet e hartuara nga Qeveria (432 dokumente që nga lansimi i platformës në shkurt 2017 deri me 31 dhjetor 2018. Zyra për Qeverisje të Mirë / Zyra e Kryeministrit ka hartuar dhe publikuar raportin e parë për rrjedhën e procesit të konsultimeve me publikun për vitin 2017⁵.

Ndarja e fondeve për OSHT-të nga buxheti i shtetit është përcaktuar nga Rregullorja për kriteret, standardet dhe procedurat për financimin publik të OSHC-ve (MF-04/2017) e miratuar në qershor të vitit 2017, e cila ka krijuar një sistem financimi publik për OSHC-të bazuar në merita, duke përfshirë rregulla dhe transparencë të përcaktuar qartë si në nivel qendror ashtu edhe në nivelin lokal. Në vitin 2017, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit ka publikuar raportin e parë në Republikën e Kosovës mbi financimin publik për periudhën 2015-2016 si dhe Raporti për vitin 2017⁶.

Sa i përket ofrimit të shërbimeve nga ana e OSHC-ve, vlen të theksohet që legjislacioni ekzistues lejon që OshC-të të ofrojnë shërbime në fusha të ndryshme. OSHC-të kanë të drejtë të aplikojnë për ofrimin e shërbimeve sipas Ligjit për shërbime sociale dhe familjare (02 / L-17). OSHC-të kanë të drejtë të aplikojnë për licencim në shërbimet sociale specifike, në bazë të standardeve të përcaktuara. Licencat janë një parakusht për të aplikuar për ofrimin e shërbimeve përkatëse dhe kjo vlen edhe për ofruesit e tjerë të shërbimeve, përveç ofruesve

³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2764>

⁴ <http://konsultimet.rks-gov.net/>

⁵ Raporti i Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyrës së kryeministrit mbi konsultimet publike 2017

⁶ Raporti i Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyrës së Kryeministrit për financimin publik të OSHC-ve 016-2017

të shërbimeve shtetërore. Në Kosovë, vetëm disa OShC janë të angazhuara në shërbime të ndryshme që paguhen nga fondet shtetërore dhe shumica e tyre janë të angazhuara në fushën e shërbimeve sociale.

Komponenti i vullnetarizmit momentalisht mbulohet përmes Ligjit për Fuqizimindhe Pjesëmarrjen e Rinisë (Ligji Nr.03/L-145) dhe Udhëzimet Administrative të Ministrisë për Kulturë, Rinidhe Sport. Ky Ligjipërkufizon aspektet rregulluese vetëm për të rinjtë nga mosha 15 deri 24 vjet. Rëndësia e vullnetarizmit është dhënë edhe përmes krijimit të ekipit të punës që është duke punuar për hartimin e koncept dokumentit për vullnetarizëm.

Metodologjia

Strategjia qeveritare për bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023 është përgatitur nga Ekipi i Punës i themeluar nga Zyra e Kryeministrit, me përfaqësues të qeverisë dhe shoqërisë civile, me mbështetje profesionale nga Zyra për Qeverisje të Mirë dhe Projekti i Asistencës Teknike i BE-së “Mbështetje për Zbatimin e Strategjisë së Qeverisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile”.

Ekipi i Punës (EP) për hartimin e Strategjisë është themeluar me vendimin e datës 12 korrik 2017, nga Sekretari i Përgjithshëm i ZKM-së para se të skadonte Strategjia e paraprake (2013-2017). Ky Ekip ka qenë shumë proaktiv në plotësimin dhe konfirmimin e vlerësimit të Strategjisë së mëparshme, duke përcaktuar fushat me prioritet dhe përkufizuar misionin/vizionin e Strategjisë për vitet 2019-2023. Ekipi është udhëhequr nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit në bashkë kryesim me Platformën Civikos në përbërje të te cilit kanë qenë përfaqësues nga Ministritë e linjës dhe Organizatat e Shoqërisë Civile.

Mjeti kryesor i analizës për hartimin e Strategjisë së re ka qenë “analiza e shkakut bazë”. Analiza e shkakut bazë është përdorur për të identifikuar problemet, sfidat dhe pengesat në zbatimin e Strategjisë së mëparshme. Ajo në thelb i ka përkufizuar problemet e bashkëpunimit në mes të qeverisë dhe shoqërisë civile si dhe mësimet e nxjerra për Strategjinë e re. Aktivitetet e ndërmarra për këtë analizë kanë përfshirë sesionet me Ekipin e punës dhe tryezat e rumbullakëta me shoqërinë civile. Menjëherë pas mbledhjes dhe analizimit të të gjitha të dhënave për problemet dhe shkaqet bazë, gjetjet janë diskutuar dhe vërtetuar përmes aktiviteteve të organizuara nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit.

Ekipi i punës ka punuar profesionalisht në vendosjen e objektivave të dokumentit dhe bazuar në këtë analizë ka zhvilluar draftin e parë të Strategjisë, i cili ka kaluar të gjitha fazat e konsultimit. Procesi i konsultimit publik të dokumentit së bashku me të gjitha detyrimet e përcaktuara me Rregulloren për Standardet Minimale për Konsultimet Publike është zhvilluar me sukses me disa sesione konsultative nëpër rajone. Me qëllim të sigurimit të kontributit sa më të gjerë nga OSHC-të dhe palët e tjera, janë zhvilluar takime konsultative në 5 rajone - Mitrovicë, Pejë, Prishtinë, Prizren dhe Gjilan⁷, në tetor dhe nëntor 2018. Paralelisht, Strategjia dhe teksti i Planit të Veprimit janë vënë në dispozicion për konsultim për të gjithë qytetarët e interesuar në Platformën Online për konsultime publike (konsultime.rks-gov.net) duke filluar nga data 4 tetor deri me 9 nëntor⁸ (34 ditë). Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik, Ekipi i Punës është takuar dhe i ka analizuar e diskutuar të gjitha kontributet e pranuar nga procesi i konsultimit për ta finalizuar draftin e fundit që është përcjellë për miratim në Qeveri.

⁷ Në përgjithësi, 54 përfaqësues të OSHC-ve, palëve të interesuara dhe qytetarëve kanë marrë pjesë në takimet konsultuese. Takimet kanë rezultuar me 43 rekomandime dhe komente specifike.

⁸ Afati fillestar për konsultim u zgjat nga 1 deri në 9 nëntor për të lejuar procesin e konsultimeve on-line të shoqërojnë takimet racionale të konsultimeve dhe të sigurojnë hapësirë për komentet shtesë që do të sigurohen nga organizatat dhe palët e interesuara.

Historiku i Problemit

Problemi kryesor që ky dokument strategjik synon të adresojnë mënyrë specifike ndërlidhet me çështjet apo shqetësimet të cilat nuk janë implementuar në kohë në Strategjinë e mëparshme. Deri tani, pjesa më e madhe e progresit në zbatim të Strategjisë së mëparshme është arritur gjatë viteve 2016 dhe 2017ku shkalla e progresit ka arritur në 73 përqind⁹, sa i përket zbatimit të aktivitetevendërsa nëse progresi do të matej në bazë të rezultateve dhe ndikimit përqindja do të ishte më e vogël. Zbatimi i Strategjisë (2013-2017) ka filluar me vonesë pas hyrjes në fuqi në vitin 2013, ku aktivitetet e planifikuara gjatë viteve 2013-2014 janë zhvendosur për vitin 2015. Për shkak të mungesës së burimeve financiare dhe njerëzore, Strategjia ka filluar së zbatuari me një ritëm të ngadalshëm, mirëpo me përkushtimin e Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyrës së Kryeministrit dhe mbështetjes nga një sërë organizata vendore, donatorë ndërkombëtar dhe nga Projekti i Asistencës Teknike të BE-së ka arritur që me sukses të implementojë shumicën e masave të planifikuara.

Gjatë katër (4) viteve të fundit, marrëdhëniet në mes të shoqërisë civile dhe qeverisë janë përmirësuar dukshëm. Strategjia (2013-2017) ka qenë një mjet i politikave duke e vendosur bazën e bashkëpunimit në mes të qeverisë dhe shoqërisë civile, me qëllim të krijimit të një mjedisi përkrahës për zhvillimin e sektorit të shoqërisë civile në vend!¹⁰ Rrjedhimisht, shoqëria civile gjithnjë e më shumë është duke u përfshirë në politikë-bërje. Miratimi i Rregullores Nr.05/2016 mbi Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit me Publikun (prill 2016) dhe lansimi i Platformës Online për Procesin e Konsultimeve me Publikun (shkurt 2017) tregojnë shembullin me të mirë të bashkëpunimit. Prandaj, për vazhdim të suksesit duhet të bëhen përpjekje shtesë siç edhe janë paraparë në këtë Strategjinë.

Në mars të vitit 2017, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit në bashkëpunim me Ministrinë e Financave kanë përgatitur dhe publikuar Raportin për Mbështetjen Financiare Publike për OSHC-të nga Institucionet e Republikës së Kosovës për Vitet 2015 - 2016. Shumë analistë të politikave dhe aktivist të shoqërisë civile e shohin këtë si një sukses madhor, pasi që informacioni për financimin e shoqërisë civile nga qeveria nuk është publikuar në të kaluarën. Krahas kësaj, në qershor të vitit 2017, është vendosur një sistem transparent dhe llogaridhënës për financimin e OSHC-ve përmes miratimit të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat për Financimin Publik të OJQ-ve nga Ministria e Financave. Rregullorja MF-04/2017 është pranuar mirë nga institucionet publike dhe OSHC-të. Mirëpo, për të vazhduar aplikimin e saj në praktikë duhet të bëhen përpjekje plotësuese me ngritje të vazhdueshme të kapaciteteve për institucionet dhe OSHC-të.

Përderisa për Objektivin e parë të Strategjisë 2013-2017, përfshirja e shoqërisë civile në politikë bërje ka qenë më e suksesshme, e cila tejkalon 90 përqind të nivelit të progresit, te pjesa tjetër e fushave të politikave mbetet akoma punë për t'u bërë. Krijimi i një sistemi për financimin publik të shoqërisë civile te paraparë te objektivi i tretë i Strategjisë ka arritur 70 përqind të nivelit të progresit. Për sa i përket objektivit strategjik për krijimin e një sistemi për kontraktimin e OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve publike, niveli i progresit ka arritur në 50 përqind. Ndërsa niveli i promovimit të një qasjeje të integruar ndaj vullnetarizmit ka arritur në 83 përqind. Pra, vlen të theksohet se mbetet shumë për të punuar në krijimin dhe vendosjen e “një sistemi për kontraktimin e OSHC-ve për të ofruar shërbime publike” dhe për të “zhvilluar vullnetarizmin”. Mirëpo prap se prap kjo përqindje është vetëm matje kuantitative sepse nëse do të kishte indikatorë matës kualitativ, kjo përqindje do të ishte shumë më e vogël “Analiza e shkaqeve bazë” ka ndihmuar në identifikimin e të gjitha problemeve për secilën fushë me prioritet në kuadër të bashkëpunimit të qeverisë me shoqërinë civile. Për të siguruar raportimin e të gjitha problemeve dhe shkaqeve të drejtpërdrejta, raporti i vlerësimit është konsultuar ngushtë me të gjithë partnerët relevant të fushës.

⁹ Vlerësimi për Zbatimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile (2013-2017) Zyra për Qeverisje të Mirë Shkurt 2018, fq. 2-3

¹⁰ Zyra për Qeverisje të Mirë. Strategjia e Qeverisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile. 2013, fq. 2

Lista e problemeve te identifikuar bazuar ne vlerësimin e shkaqeve bazë:

1	<i>Mungesa e pjesëmarrjes adekuate të OSHC-ve në formulimin e politikave dhe legjislacionit</i>
▪	Mungesa e resurseve njerëzore dhe financiare për të monitoruar e raportuar procesin e konsultimeve me publikun
▪	Ministritë e linjës kanë pasur mungesa të kapaciteteve të zyrtarëve për të planifikuar, zbatuar dhe raportuar për standardet minimale për konsultim me publikun.
▪	Mungesa e njohurive të organizatave të shoqërisë civile (OSHC-ve) për pjesëmarrje në konsultimet publike dhe bërjen e politikave në përgjithësi.
▪	Mungesa e kapaciteteve profesionale në kuadër të organizatave të shoqërisë civile (OSHC-ve) për të kontribuar në procesin e konsultimeve me publikun.

2	<i>Financimi direkt dhe indirekt i OSHC-ve ende nuk është operacional</i>
▪	Mungesa e kapaciteteve të Ministrive dhe Komunave për programim, zbatim, monitorim dhe raportim të fondeve publike për OSHC-të ne nivelin e duhur.
▪	Mungesa e një kornize ligjore koherente dhe mbështetëse për zhvillimin e filantropisë individuale dhe të korporatave.
▪	Aktivitetet ekonomike të organizatave të shoqërisë civile (OSHC-ve) janë të kufizuara.
▪	Mungesa e sistemit të bashkëfinancimit në mënyrë që organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të) të pranojnë fonde nga Bashkimi Evropian (BE-ja).

3	<i>Praktikat e pazhvilluara dhe jo transparente për kontraktimin e OSHC-ve për të ofruar shërbime publike</i>
▪	Mungesa e njohurive në Ministri dhe Komuna për kornizën ligjore dhe modeleve që janë në dispozicion për të kontraktuar OSHC-të në ofrimin e shërbimeve publike.
▪	Mungesa e vlerësimit të nevojave dhe potencialit për ofrimin e shërbimeve publike nga organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të) në fusha të ndryshme.
▪	Mungesa e të dhënave kombëtare për organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të) si ofrues të shërbimeve publike në fusha të ndryshme.
▪	Mungesa e standardeve dhe procedurave për ofrimin e shërbimeve publike nga organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të).

4	<i>Mungesa e vullnetarizmit në programet në interes të publikut</i>
▪	Organizatorët e vullnetarëve përballen me disa pengesa administrative dhe ligjore në angazhimin dhe mbajtjen e vullnetarëve.
▪	Mungesa e standardeve dhe kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile (OSHC-ve) për të rekrutuar, angazhuar dhe menaxhuar vullnetarët.
▪	Mungesa e njohurive të publikut/zyrtarëve për mundësitë, përfitimet dhe vlerat e angazhimit në aktivitetet vullnetare.

Shkaqet e drejtpërdrejta të identifikuar nga analiza janë adresuar detajsh në raportin “Vlerësimi i Zbatimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile (2013-2017).” Megjithatë, duhet të kemi parasysh mungesën e statistikave zyrtare dhe të besueshme si dhe statistikave për sektorin e shoqërisë civile.

Objektivat Strategjike

Objektivat strategjike janë qëllime që vlerësohen si më të rëndësishme për bashkëpunimin në mes të qeverisë dhe shoqërisë civile. Ekipi i Punues iu ka dhënë prioritet objektivave strategjike me sa vijon:

1. Rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në politikë-bërje
2. Përmirësimi i kornizës institucionale dhe ligjore për financim në zhvillimin e qëndrueshëm të programeve dhe projekteve të OShC-ve me interes publik
3. Zhvillimi i praktikave dhe procedurave për kontraktimin e OShC-ve në ofrimin e shërbimeve publike
4. Rritja e vullnetarizmit për programet me interes publik

Këto objektiva janë plotësim i objektivave strategjike të vendosura në Udhëzimet për mbështetje të BE-së për shoqërinë civile në vendet në zgjerim 2014-2020. Objektivat e vendosura adresojnë reforma shumë komplekse dhe të ndërlidhura me politika të cilat së bashku mund të kontribuojnë në krijimin e një mjedisi më mbështetës për shoqërinë civile në Kosovë.

Objektivi strategjik 1. Rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në politikë-bërje

Qeveria ka bërë progres në zhvillimin e standardeve dhe praktikave për të rritur pjesëmarrjen e shoqërisë civile në hartimin e politikave dhe legjislacionit. Rregullorja për Standardet Minimale në Procesin e Konsultimit me Publikun (Nr.05/2016) është miratuar në muajin prill 2016. Platforma Qendrore Online për Konsultime me Publikun është lansuar në muajin shkurt 2017, ku palët e interesuara nga shoqëria civile dhe publiku i gjerë kanë mundësinë të regjistrohen dhe ofrojnë kontributin për hartimin e politikave apo legjislacionit¹¹. Në po të njëjtin vit, është përgatitur dhe mbajtur programi trajnues¹² për shërbyesit civil për zbatimin e Rregullores dhe funksionimin e Platformës Online. Zyra për Qeverisje të Mirë dhe Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) kanë nënshkruar Memorandum të Mirëkuptimit për Bashkëpunim në organizimin trajnimeve mbi Standardet minimale të konsultimeve publikembi të cilin janë trajnuar rreth 100 përfaqësues të shoqërisë civile për këto standarde.

Gjatë vitit të parë të zbatimit, më shumë se dyqind konsultime publike janë lansuar përmes Platformës online. Megjithatë, mbetet ende punë për inkurajimin e publikut për të qene pjese e politikë-bërjes. Për të arritur efekt më të madh në praktikë, duhet të bëhen përpjekje të shtuara për zhvillimin e kapaciteteve të institucioneve publike dhe shoqërisë civile për të përmirësuar pjesëmarrjen në konsultim edhe përmes metodave tjera përveç formësonlinesiç janë pjesëmarrja në grupe punese, takime publike, punëtori etj. Për më tepër, procesi i konsultimit (në internet dhe forma tjera) në nivel lokal ku vendimet ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e përditshme të qytetarëve duhet të përmirësohen përmes informimit dhe ndërtimit të kapaciteteve mbi standardet e përcaktuara në Rregullore.

¹¹ Konsultimet.rks-gov.net

¹² Programi trajnues është realizuar nga ZQM-ZKM dhe Projekti i AT te BE-së

Objektivi strategjik 1		Objektivat Specifike	
1	Rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në politikë-bërje	1.1	Përmirësimi i kapaciteteve të institucioneve për zbatimin e standardeve minimale për konsultime me publikun
		1.2	Ngritja e njohurive për qytetarë dhe shoqërinë civile për konsultimet publike
		1.3	Përmirësimi i kapaciteteve të OSHC-ve për të kontribuar në procesin e konsultimeve publike

Objektivi strategjik 2. Përmirësimi i kornizës institucionale dhe ligjore për financim në zhvillimin e qëndrueshëm të programeve dhe projekteve të OShC-ve me interes publik

Qeveria e Republikës së Kosovës ka vendosur praktikën, standardet dhe kriteret për ndarjen e fondeve publike për shoqërinë civile përmes rregullores 04/2017 për Kriteret, Standarde dhe Procedurat për Financimin Publik të OSHC-ve. Në mars të vitit 2016, Zyra për Qeverisje të Mirë /Zyra e Kryeministrit në bashkëpunim me Ministrinë e Financave (MF) kanë përgatitur dhe publikuar për herë të parë Raportin për Mbështetjen Financiare Publike për OSHC-të nga Institucionet e Republikës së Kosovës për vitet 2015-2016. Në bazë të të dhënave të siguruar nga Ministria e Financave, rezultoni se mbështetja publike financiare që i është dhënë OSHC-ve nga institucionet publike qendrore dhe lokale gjatë viteve 2015-2016 kapin shumën totale të financimit prej 27,859,305.00 Euro. Në këtë shumë përfshihet mbështetja financiare për OJQ, klube e federata sportive dhe entitete tjera të cilat janë po ashtu të regjistruara si OSHC. Në mungesë të kornizës së qartë rregulluese, shumica të konsiderueshme të mbështetjes financiare për OJQ-të janë ndarë përmes vendimeve dhe kontraktimit të drejtpërdrejt, pa procedura të unifikuar. Në fund të muajit qershor 2017, Ministria e Financave ka miratuar Rregulloren e cila i përcakton *kriteret, standardet dhe procedurat bazë* për financimin publik të OJQ-ve. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është “krijimi i një sistemi transparent dhe llogaridhënës”¹³ për financimin e projekteve dhe programeve të OSHC-ve. Megjithatë, duhet të shtohen përpjekjet për ndërtimin e kapaciteteve në mesin e institucioneve publike dhe shoqërisë civile për zbatimin e Rregullores.

Për sa i përket mekanizmave dhe praktikave të financimit indirekt, nuk është bërë progres i mjaftueshëm për rregullimin e aktiviteteve ekonomike të OSHC-ve. Qeveria nuk ka krijuar një kornizë ligjore për zhvillimin e filantropisë individuale dhe korporative. Kjo kërkon krijimin e një kornize ligjore gjithëpërfshirëse për një mjedis më të favorshëm për OSHC-të, të cilat merren me filantropi (përfshirë edhe dhurimet, harmonizimin e statusit të përfitimit publik në legjislacionin përkatës) dhe aktivitete ekonomike. Krahas kësaj, në të kaluarën ndarja e pronës shtetërore për shfrytëzim nga OSHC-të nuk ka qenë e rregulluar. Qeveria duhet të ndërmarrë veprime strategjike për të identifikuar dhe publikuar tërë informacionin për pronën shtetërore (lokale dhe nacionale) e cila është në përdorim dhe/ose do të jetë në përdorim të OSHC-ve, gjë që në fund do të kërkojë miratimin e një politike rregulluese apo një rregulloreje. Në fund, Qeveria duhet të krijojë një sistem për bashkëfinancim të projekteve të OSHC-ve të financuara nga BE-ja, gjë që në të kaluarën nuk ka ekzistuar.

¹³ MF. Rregullorja 04/2017 për Kriteret, Standarde and Procedurat për Financimin Publik të OJQ-ve. Neni 1 13 qershor 2017, fq. 2

	Objektivi strategjik 2	Objektivat Specifike	
2	Përmirësimi i kornizës institucionale dhe ligjore për përkrahje financiare dhe jo financiare në zhvillimin e qëndrueshëm të programeve dhe projekteve të me interes publik të OShC-ve	2.1	Fuqizimi i kapaciteteve të Ministrive dhe Komunave për zbatimin e standardeve për financimin publik të OSHC-ve
		2.2	Përmirësimi i kornizës ligjore dhe institucionale për zhvillimin e filantropisë individuale dhe të korporatave
		2.3	Rregullimi i ndarjes së pronës publike për shfrytëzim nga OSHC-të
		2.4	Krijimi i një sistemi për bashkëfinancim të projekteve të OSHC-ve të financuara nga BE-ja

Objektivi strategjik 3. Zhvillimi i praktikave dhe procedurave për kontraktimin e OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve publike

Qeveria ende nuk ka zhvilluar praktika dhe procedura të përshtatshme për kontraktimin e OSHC-ve për të ofruar shërbime publike. Vlerësimi i sfidave dhe mundësive për kontraktimin e OShC-ve për të ofruar shërbime publike në Kosovë, i përgatitur në vitin 2017¹⁴ ka identifikuar në mes të tjerave nevojën për të zhvilluar një bazë kombëtare me të dhëna për ofruesit e shërbimeve publike/sociale, e cila do të lehtësonte krijimin e një mekanizmi kombëtar referues gjithëpërfshirës. Kjo bazë do të ofrojë të dhëna për planifikimin adekuat të shërbimeve sipas nevojës në secilën komunë si dhe standardet për kontraktimin e OShC-ve. Për më tepër është theksuar edhe nevoja për të forcuar mekanizmat për sigurimin e cilësisë për shërbimet e kontraktuara si dhe për të përmirësuar kapacitetet e ministrive dhe komunave për monitorim dhe vlerësim.

Qeveria duhet të hartojë dhe miratojë standardet dhe procedurat për ofrimin e shërbimeve publike nga OSHC-të duke përfshirë edhe mbulimin e licencave. Në ndërkohë, duhet të rriten njohuritë për institucionet rreth rëndësisë së kornizës ligjore dhe modeleve që janë në dispozicion për të kontraktuar OSHC-të në ofrimin e shërbimeve.

	Objektivi strategjik 3	Objektivat Specifike	
3	Zhvillimi i praktikave dhe procedurave transparente për kontraktimin e OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve publike	3.1	Përmirësimi i kornizës së përgjithshme politike dhe institucionale për rregullimin e aktiviteteve ekonomike të OSHC-ve
		3.2	Përmirësimi i njohurive të institucioneve rreth mundësive (modeleve) që janë në dispozicion për kontraktimin e OSHC-ve
		3.3	Mbledhje dhe publikim sistematik i informatave mbi potencialin e OshC-ve për të ofruar shërbime publike për institucionet publike” (te harmonizohet pastaj edhe ne Plan te Veprimit
		3.4	Përmirësimi i legjislacionit që rregullojnë standardet dhe procedurat për ofrimin e shërbimeve publike nga OSHC-të

¹⁴ Vlerësimi i sfidave dhe mundësive të kontraktimit të OSHC-ve për të ofruar shërbime publike në Kosovë, Zyra për Qeverisje të Mirë, faqe.35.

Objektivi strategjik 4. Rritja e vullnetarizmit në programet me interes publik

Për të ofruar një bazë të qëndrueshme analitike në formulimin e masave për mbështetje në zhvillimin e vullnetarizmit, është realizuar një studim mbi vullnetarizmin. Për këtë qëllim janë organizuar një sërë aktivitetesh në formën e punëtorive dhe grupeve të fokusit, të cilat kanë ndihmuar në formësimin e këtij studimi.

Gjetjet kryesore të studimit tregojnë se duhet të hiqen pengesat administrative dhe ligjore dhe të miratohet një politikë me qëllim të vendosjes së standardeve dhe procedurave për angazhimin e vullnetarëve. Në përputhje më këtë dhe varësisht nga zhvillimi i politikave të vendoset një sistem për monitorimin dhe raportimin mbi vullnetarizmin në vend. Në këtë kontekst, Kryeministri ka dhënë mbështetjen e tij për zhvillimin e vullnetarizmit dhe si rezultat është themeluar ekipi për Hartimin e koncept Dokumentit për Vullnetarizëm.

	Objektivi strategjik 4	Objektivat Specifike	
4	Rritja e vullnetarizmit në programet në interes publik	4.1	Krijimi e një kornize gjithëpërfshirëse ligjore dhe institucionale për të mbështetur zhvillimin e vullnetarizmit
		4.2	Zhvillimi i kapaciteteve të OSHC-ve për të rekrutuar, angazhuar dhe menaxhuar vullnetarët
		4.3	Rritja e njohurive të qytetarëve për mundësitë dhe vlerat e vullnetarizmit

Monitorimi dhe Vlerësimi i Zbatimit të Strategjisë

Mekanizmi kryesor që do ta koordinoj të gjithë procesin e bashkëpunimit të qeverisë me shoqërinë civile do të jetë Këshilli për bashkëpunim qeveri –shoqëri civile. Mandati i Këshillit nuk do të kufizohet vetëm në zbatimin e strategjisë qeveritare por ai do të mbuloj të gjitha aspektet e bashkëpunimit në mes të qeverisë dhe shoqërisë civile duke përfshirë:

- Monitorimin e zbatimit të Strategjisë së Qeverisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023
- Dhënien e opinioneve dhe këshillave për projektligjet, dokumentet strategjike dhe dokumenteve tjera që ndikojnë në punën dhe zhvillimin e OSHC-ve, me qëllim të krijimit të një mjedisi më të përshtatshëm për shoqërinë civile në Kosovë
- Jep opinion për raportet vjetore mbi shpërndarjen e fondeve publike për mbështetjen e qëndrueshmërisë së programeve dhe projekteve të OSHC-ve.

Institucioni kryesor për koordinimin e punës së Këshilli do të jetë Zyra për Qeverisje të Mirë/ Zyra e Kryeministrit e cila do të shërbej edhe si sekretariat i këshillit. Gjithashtu, monitorimi i zbatimit të Strategjisë për bashkëpunim Qeveri-Shoqëri civile do të bëhet nga Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë me përkrahjen e Këshillit për bashkëpunim qeveri –shoqëri civile¹⁵. Monitorimi dhe vlerësimi i strategjisë mundëson ruajtjen e qëndrueshmërisë dhe përcjelljen e tërësisë së rregullave dhe treguesve të caktuar nga Komisioni Evropian (KE) në Udhëzimet për Zgjerim të DP të Komisionit Evropian për Mbështetjen e BE-së për Shoqërinë Civile në Vendet e Zgjerimit 2014-2020.

16¹⁵ Për më shumë detaje, shih **Shtojcën 3**.

Përgjegjësia për bashkërendimin e monitorimit dhe raportimit të Strategjisë dhe planit të veprimit i takon Zyrës për Qeverisje të Mirë /Zyrës së Kryeministritpor përfshirja e të gjitha institucioneve përgjegjëse për aktivitete përkatëse është vendimtare si për zbatim, ashtu edhe për monitorim e raportim të duhur. Këshilli është përgjegjës për të ofruar këshilla dhe vlerësime mbi zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë dhe arritjen e objektivave strategjike dhe është përgjegjës për të ofruar konsulencë mbi cilësinë e monitorimit, vlerësimit dhe raportimit për Strategjinë, të bazuar në indikatorë cilësor me qëllim të evitimit të problemeve eventuale gjatë monitorimit të strategjisë. Këshilli, përveç rolit të tij për monitorim dhe vlerësim mund të iniciojë dhe aplikojë masa për një zbatim më të suksesshëm të Strategjisë dhe politikave në praktikë. Roli i Zyrës për Qeverisje të Mirë si Sekretariat i Këshillit është që të ofrojë mbështetje profesionale dhe administrative në përgatitjen e takimeve të Këshillit, për të vlerësuar nivelin e zbatimit të objektivave dhe aktiviteteve të Strategjisë dhe planit të veprimit.

Përzgjedhja e anëtarëve të Këshillit do të bëhet në mënyrë të hapur, transparente dhe të përgjegjshme. Kriteret për përzgjedhje në mënyrë të barabartë përfshijnë përfaqësimin (p.sh. kandidatët që kanë mbështetje të gjerë në shoqërinë civile, inkurajojnë emërimin e grave, anëtarët e komuniteteve jo-shumicë dhe grupet e nën-përfaqësuar) dhe ekspertizën (p.sh. kandidatët që kanë njohuri, një fushë të caktuar tematike) të anëtarëve të përzgjedhur që vijnë nga institucionet publike dhe nga radhët e shoqërisë civile. Secili anëtar duhet gjithashtu të plotësojë kriteret minimale, duke përfshirë vitet minimale të punës dhe përvojën në fushën dhe sektorin përkatës (publik ose shoqëri civile) etj. Udhëzimet e mësipërme të kriterëve do të zhvillohen edhe më tepër së bashku me rregullat dhe procedurat për procesin e përzgjedhjes.

Këshilli mblidhet dhe funksionon në bazë të rregullave të punës të miratuara bashke me këtë strategji. Për të ndihmuar punën e këshillit janë të caktuara Ekipet e Punës për çdo objektiv strategjik. Qëllimi i krijimit të EP-ve është që ato të ndihmojnë Këshillin për të qenë më efektiv në ushtrimin e rolit të tij dhe për të baraspeshuar punën e tij me punën e Sekretariatit. Ekipet e Punës përbëhen nga përfaqësues të ministrive përkatëse të linjës dhe përfaqësues të zgjedhur të OSHC-ve në Këshill. Përveç kësaj, përfaqësues të tjerë të jashtëm (OSHC ose ekspertë) mund të ftohen me iniciativën e Këshillit nëse konsiderohen se sjellin vlerë të shtuar në procesin e zbatimit të aktiviteteve të Strategjisë apo edhe të M & V. Secili anëtar i emëruar në Ekipet e Punës do të marr pjesë në takimet e Këshillit dhe në aktivitetet e tjera për të siguruar përkushtimin e plotë të të gjithë palëve të interesuara.

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit duhet të raportoj mbi përparimet në progresin e Strategjisë dhe Planit të saj të Veprimit në baza vjetore. Raporti vjetor i progresit do të përgatitet deri në fund të çerekut të parë të vitit vijues. Matrica për Monitorim dhe Raportim do të përdoret si instrument për të vlerësuar progresin dhe sfidat në zbatimin e Strategjisë. Ky sistem do të përbëhet nga “treguesit e bazuar në performancë” të cilët janë dizajnuar për të matur rezultatet dhe nivelin e ndikimit që Strategjia do të ketë në praktikë. Logjika se si janë përkufizuar treguesit është ilustruar në Shtojcën 4.

Strategjia do të shoqërohet me Planin e Veprimit 2019-2021, i cili do të përditësohet në baza vjetore. Strategjia do të ketë një vlerësim afatmesëm dhe një vlerësim final. Bashkë me raportin për vitin 2019, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit do të bëjë një vlerësim/rishikim afatmesëm të objektivave dhe treguesve. Vlerësimi afatmesëm dhe final i strategjisë do të përqendrohen në zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit si dhe përmirësimet potenciale në mënyrë që të arrihen rezultatet dhe objektivat e synuara. Kjo do të bëhet duke përditësuar objektivat sipas nevojës bazuar në të dhënat e disponueshme për vitin 2019, si pikënisje për matjen e progresit të Strategjisë. Meqenëse burimet e të dhënave (ose mjetet e verifikimit) për treguesit e bazuar në rezultate në disa raste nuk janë parashikuar përmes rezultateve apo aktiviteteve individuale të Strategjisë, është thelbësore që më së voni pas dy viteve ZQM/ZKM propozon zhvillimin e masave shtesë për të siguruar mbledhjen e të dhënave të tilla, p.sh. monitorimi i procesit të konsultimit në nivel komunal, financimi publik për OSHC-të në

nivel komunal, shkalla dhe lloji i vullnetarizmit, etj. Kjo gjithashtu do të mundësoj ndërlidhjen me përmbushjen e treguesve të Strategjisë / PV përkitazi me Udhëzimet e BE-së për shoqëri civile për aq sa kjo është relevante për Strategjinë / planin e veprimit. Procesi i vlerësimi dhe rishikimit të Strategjisë do të ndërlidhet edhe me rishikimin dhe vlerësimin e Reformës së Administratës Publike (indiktorët për mbështetjen buxhetore sektoriale, konkretisht indikatorit 2 - konsultimet publike).

Funksionalizimi i procesit të monitorimit dhe vlerësimit

Plani i Veprimit (PV) 2019-2021 për zbatimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile parasheh hapa që duhet të ndërmerren në lidhje me monitorimin dhe raportimin:

Hapi 1	Hartimi dhe miratimi i Raportit të parë mbi Zbatimin e Strategjisë / PV 2019
Hapi 2	Rishikimi dhe përditësimi (nëse është e nevojshme) të Planit të Veprimit 2019-2021
Hapi 3	Hartimi dhe miratimi i Raportit të 2 -të për Implementimin e Strategjisë / PV 2020
Hapi 4	Rishikimi, përditësimi (nëse është e nevojshme) të Planit të Veprimit 2019-2021 dhe hartimi dhe miratimi i Planit të Veprimit 2021-2023
Hapi 5	Hartimi dhe miratimi i Raportit të 3-të për Zbatimin e Strategjisë / PV 2021
Hapi 6	Realizimi i rishikimit / vlerësimin afatmesëm të zbatimit të Strategjisë / PV
Hapi 7	Rishikimi dhe përditësimi (nëse është e nevojshme) i Planit të Veprimit 2021-2023
Hapi 8	Hartimi dhe miratimi i Raportit të 4-të mbi Zbatimin e Strategjisë / PV 2022
Hapi 9	Rishikimi dhe përditësimi (nëse është e nevojshme) i Planit të Veprimit 2019-2021
Hapi 10	Hartimi dhe miratimi i Raportit të 5-të mbi Zbatimin e Strategjisë / PV 2023
Hapi 11	Rishikimifafatmesëm / vlerësimi i zbatimit të Strategjisë / PV

Nën koordinimin e Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit dhe me përkrahje e Ekipëve të punës përgatiten Raportet e monitorimit të cilat dorëzohen në Këshill në baza vjetore. Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, e cili ka rolin kyç koordinues për zbatimin e Strategjisë / PV dhe rrjedhimisht është përgjegjëse për të siguruar ose koordinuar qasjen në të dhënat për Ekipet e punës për të qenë në gjendje t'i kryejnë detyrat e veta. Tabela e mëposhtme ofron informacione për burimet kryesore të të dhënave (mjetet e verifikimit) për treguesin e nivelit të rezultatit (ndikimit), ministrinë përgjegjëse, shpeshtësinë, afatin kohor të publikimit / afatin e fundit,etj.

Tabela e të dhënave për nivelin e arritjes së rezultateve dhe mjetet e verifikimit

Objektivi Strategjik / treguesi	Ministria përgjegjëse / një-sia e qeverisë/ komuna	Burimi i të dhënave (mjetet e verifikimit)	Periudha kohore	Afati i publikimit / Afati i fundit
Objektivi strategjik 1: Rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në hartimin e politikave				

1.1 Përmirësimi i kapaciteteve të institucioneve për zbatimin e standardeve minimale për konsultime me publikun	ZQM/ZKM (me mbështetjen e projektit të AT të BE-së) MAPL për nivel lokal	Raport vjetor për zbatimin e Rregullores për standardet minimale të konsultimeve publike	Vjetore	31 Mars i vitit vijues
1.2 Ngritja e njohurive të qytetarëve dhe shoqërisë civile për konsultimet publike	ZQM/ZKM (me mbështetjen e projektit të AT të BE-së) MAPL për nivel lokal	Numrit të organizatave të shoqërisë civile dhe qytetarëve të regjistruar në Platformën Online	Vjetore	31 Mars i vitit vijues
1.3 Përmirësimi i kapaciteteve të OSHC-ve për të kontribuar në procesin e politikë-bërjes	ZQM/ZKM	Numri i OSHC-ve të trajnuara në procesin e politik bërjes për zbatimin e Rregullores, përdorimin e Platformës Online, përfshirjen në EP, mënyrat tjera të konsultimit si dhe nr. i atyre qo kontribuojnë në konsultimet publike.	Vjetore	Raport vjetor 150 OSHC për vit
Objektivi strategjik 2: Përmirësimi i kornizës institucionale dhe ligjore për financim në zhvillimin e qëndrueshëm të programeve dhe projekteve të OShC-ve me interes publik				
2.1 Fuqizimi i kapaciteteve të Ministrive dhe Komunave për zbatimin e standardeve për financimin publik të OSHC-ve	MF ZQM/ZKM Projekti i AT	Numri i shërbyesve civil të trajnuar për kriteret, standardet dhe procedurat, e financimit publik të OSHC-ve Organizimi institucional për mbikëqyrje të zbatimit të standardeve për financim publik	Vjetore	Raport vjetor
2.2 Përmirësimi i kornizës ligjore dhe institucionale për zhvillimin e filantropisë individuale dhe të korporatave	MF Projekti i AT	Korniza ligjore gjithëpërfshirëse për filantropinë individuale dhe të korporatave e përgatitur/ Koncept dokumenti e krijuar	N/A	2020
2.3 Rregullimi i ndarjes së pronës publike për shfrytëzim nga OSHC-të	MMPH MAP MAPL	Regjistri elektronik (raporti/çasje)	N/A	2021

Objektivi specifik 2.4 Krijimi i një sistemi të bashkëfinancimit për projektet e OSHC-ve të mbështetura nga BE-ja	MIE, MF	Korniza rregulluese dhe institucionale për bashkëfinancim të projekteve të OSHC-ve të mbështetura nga BE e analizuar dhe miratuar	N/A	2021
Objektivi strategjik 3: Zhvillimi i praktikave dhe procedurave të kontraktimit të OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve publike				
3.1 Përmirësimi i kornizës së përgjithshme ligjore dhe institucionale për rregullimin e aktiviteteve ekonomike të OJQ-ve	MF ATK Projekti i AT	Korniza ligjore e konsoliduar (posaçërisht Ligji për Tatimin në të Ardhura të Korporatave)	N/A	2021
Objektivi specifik 3.2, 3.3 & 3.4 (ofrimi i shërbimeve sociale)	ZKM	Baza e të dhënave online (Raport / qasje) Raporti i mekanizmit të referimit	N/A	2021
Objektivi Strategjik 4 Krijimi i një kuadri gjithëpërfshirës ligjor dhe institucional për mbështetjen e zhvillimit të vullnetarizmit				
Objektivi specifik 4.1, 4.2 & 4.3	ZKM, MKRS, MPMS, MF	Koncept dokumenti për vullnetarizëm i përgatitur	N/A	2021

Ndikimet Financiare në Implementimin e Strategjisë

Kjo strategji është pajisur me objektiva dhe veprime që janë më realiste dhe të arritshme. Për këtë Strategji, Qeveria ka vendosur që të ndajë buxhet për zbatimin e saj. Kjo është posaçërisht e rëndësishme për të ndihmuar Zyrën për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit, ku përpos buxhetit të miratuar për aktivitete është paraparë edhe të bëhet rekrutimi i dy zyrtarëve të rinj të cilët do të jenë përgjegjës për të ndihmuar zbatimin e strategjisë. Efektiviteti i zbatimit të strategjisë varet shumë nga kapacitetet shtesë me resurse njerëzore në kuadër të Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyrës së Kryeministrit.

Buxheti i llogaritur për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit është **253.500 EUR**.

Pasqyra e kostos së Strategjisë e ndarë sipas viteve 2019/2020/2021

Kostoja përmblendhëse e strategjisë	2019	2020	2021
Mbështetja nga buxheti i Kosovës	29,500	57,000	97,000
Mbështetja e donatorëve potencialë	30,000	20,000	20,000
Totali	59,500	77,000	117,000

Pasqyra e kostos së Strategjisë (Për objektiva strategjike dhe objektiva specifike)

Objektivat Strategjike dhe objektivat specifike	Vlerësimi i kostos (në EUR)
Objektivi Strategjik 1: Rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në politikë bërje	
Objektivi specifik 1.1 Përmirësimi i kapaciteteve të institucioneve shtetërore qendrore dhe komunave për përfshirjen e OSHC-ve në politikë bërje	69.000
Objektivi specifik 1.2 Rritja e vetëdijes së qytetarëve dhe shoqërisë civile për konsultimet publike	10.500
Objektivi specifik 1.3 Përmirësimi i kapaciteteve të OSHC-ve për të kontribuar në procesin e politikë bërjes	6.000
